



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 3, DATË 16.01.2020

PËR

**KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË SË LICENCËS SË SHOQËRISË “KOMBI”
SH.P.K., PËR SUBJEKTIN AUDIOVIZIV PRIVAT VENDOR “TV KOMBI”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: AMA, kryesisht

Objekt: Konstatimi i pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Kombi” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “Tv Kombi”.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16, neni 68, germa “b” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VËREN

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 22/16, datë 30.10.2000, ka licencuar shoqërinë “Kombi” sh.p.k., për transmetime televizive analoge për të ofruar shërbim në “*Rrethet Fier dhe Mallakastër, pjesërisht rrethet Lushnjë dhe Berat*”. AMA me vendimin nr. 199, datë 25.10.2017 ka zëvendësuar licencën e subjektit me licencë për transmetime analoge dhe ka rinovuar këtë të fundit me afat deri në datën e mbylljes së transmetimeve analoge.

Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas mbylljes së transmetimeve analoge në secilin qark, subjektet e

pajisur me licenca për transmetime analoge duhet të pajisen me licencë për shërbimin e programit audioviziv.

Transmetimet audiovizive analoge në qarkun e Beratit janë mbyllur në datën 03 gusht 2017 ndërsa në qarkun e Fierit janë mbyllur në datën 1 prill 2018. AMA, në zbatim të ligjit nr. 97/2013, të sipërcituar dhe Strategjisë për Kalimin nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012, me shkresat nr. 2251 prot., datë 16.05.2018 dhe nr. 94 prot., datë 09.01.2019, ka kërkuar nga subjekti, depozitimin e kontratës për mbështetje në njërin nga rrjetet numerike tokësore.

Nga monitorimet e kryera nga AMA, në datat 11 janar 2018, dhe 24 prill 2018 dhe 15 janar 2019 ka rezultuar se subjekti nuk e mbështet shërbimin e tij programor në asnjë prej rrjeteve kombëtare, publik apo privat, duke mos ushtruar aktivitet audioviziv në qarkun e Beratit dhe Fierit. Duke qenë se subjekti nuk ka depozituar kontratë për mbështetje në rrjetin numerik si dhe nuk transmeton në teknologjinë numerike, AMA nuk mund të pajisë shoqërinë “Kombi” sh.p.k., me licencë shërbimi programi audioviziv.

Subjektit në komunikimin shkresor i është bërë me dije se në rast se nuk do të mbështesë shërbimin e tij programor në njërin prej rrjeteve numerike, AMA, do të procedojë me konstatimin e pavlefshmërisë së licencës për transmetime analoge në zonën “*Rrethet Fier dhe Mallakastër, pjesërisht rrethet Lushnjë dhe Berat*”.

Nga ana tjetër, AMA ka njoftuar në mënyrë të përsëritur mbi detyrimet financiare që subjekti ka ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit në masën 415,000 lekë, prej të cilave 223,000 lekë për pagesë vjetore për licencë të viteve 2016-2017 dhe 192,000 lekë për tarifë për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive për vitet 2016-2017.

Duke qenë se nga ana e subjektit nuk u morën masat për shlyerjen e plotë të detyrimeve financiare pavarësisht njoftimeve të përsëritura, AMA me shkresën nr. 4589 prot., datë 27.12.2019, njoftoi subjektin për procedimin administrativ për vlefshmërinë e licencës së shoqërisë “Kombi” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV Kombi”.

Me shkresën nr. 68 prot., datë 09.01.2020, subjektit i është bërë me dije se shqyrtimi administrativ për vlefshmërinë e licencës të shoqërisë “Tv Kombi” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “Tv Kombi”, do të bëhej në mbledhjen e AMA-s, së datës 16 janar 2020.

Pavarësisht, njoftimeve të përsëritura nga ana e AMA-s, subjekti nuk ka marrë asnjë masë për mbështetjen e shërbimit të tij programor në njërin prej rrjeteve numerike si dhe vijon të jetë debitor ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit në masën 415,000 lekë.

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 68 germa “b” të tij, parashikon se licenca bëhet e pavlefshme kur i licencuari njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit.

Për sa më sipër, AMA arrin në përfundimin se duke qenë se subjekti pavarësisht njoftimeve dhe kërkesave të AMA-s, nuk mbështet shërbimin e tij programor në asnjë prej rrjeteve numerike publik apo privatë duke ndërprerë transmetimet audiovizive, si dhe vijon të jetë debitor ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit, licenca e shoqërisë “Kombi” sh.p.k., duhet të bëhet e pavlefshme.

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 68, germa "b" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë "Kombi" sh.p.k., licencuar me vendimin nr. 22/16, datë 30.10.2000 të KKRT-së, për subjektin audioviziv privat vendor "Tv Kombi".
2. Subjekti, shoqëria "Kombi" sh.p.k., vijon të jetë debitor ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit në masën 415,000 lekë.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA